



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 65/5 prot.

Tiranë, më 6.2.2020

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 224, datë 20.12.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Astrit Kalaja
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijëni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 22.1.2020, është njoftuar vendimi nr. 224, datë 20.12.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit z. Astrit Kalaja, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Shkodër.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, unë, Komisioneri Publik Florian Ballhysa ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 224, datë 20.12.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Astrit Kalaja, ushtron detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Shkodër dhe, në zbatim të pikës 3 të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1¹ e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit z. Astrit Kalaja ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kritereve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Për këtë qëllim,

¹ Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, DH dhe E të këtij aneksi dhe ligjit.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni), në zbatim të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si raportin për vlerësimin e pasurisë nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si *ILDKPKI*), raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si *DSIK*) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim referuar si *KLJG*), nga të cilat rezulton se:

2.1 *ILDKPKI*, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “*Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin Astrit Kalaja*”, ka referuar për subjektin se:

- i. Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ii. Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- iii. Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv. Nuk ka kryer deklarim të rremë;
- v. Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 *DSIK*, bazuar në nenin 39, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Astrit *** Kalaja, i ka referuar Komisionit “*Papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës*”.

2.3 *KLJG*, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ka përcjellë pranë Komisionit raportin për aftësitë profesionale, së bashku me vlerësimin e denoncimeve nga publiku.

3. Përfundimet e Komisionit për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

3.1 **Për vlerësimin e pasurisë.** Referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, hetimi administrativ i Komisionit është shtrirë në kontrollin e saktësisë dhe të mjaftueshmërisë së deklarimeve, ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, ligjshmërinë e të ardhurave, shpenzimet etj., për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të. Komisioni, pasi ka analizuar dhe vlerësuar provat dhe faktet e dala nga hetimi administrativ, provat dhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e barrës së provës, ka arritur në përfundimin se: [...] *Konsideron të nevojshme kryerjen e një analize logjiko-ligjore të panoramës që paraqesin deklaratimet e kryera nga subjekti mbi gjendjen cash, për të qartësuar dinamikën, ekzistencën dhe ndërthurjen e mundshme midis tre faktorëve përcaktues: qëllim – shkak – pasojë. Verifikimi krahasues, për sa më lart, është kryer duke mbajtur parasysh edhe shpjegimet e subjektit me qëllim vlerësimin e nivelit të besueshmërisë dhe bindshmërisë që mbartin apo transmetojnë dhe, duke u përqendruar te mospërputhja e përgjigjeve të dhëna nga subjekti në pyetësonin nr. 2, me deklaratimet cash ndër vite, si dhe te burimet e ligjshme financiare për krijimin e shumave në fjalë. Për sa i përket mospërputhjeve të përshkruara në këtë pikë, Komisioni, siç e ka trajtuar edhe në argumentimet e mësipërme, i konsideron ato si pasaktësi formale (në deklaram) pa pasoja thelbësore, për sa kohë (pasaktësitë) nuk janë përdorur për paraqitjen e një shtate financiare të ndryshme nga realiteti, me qëllim rritjen fiktive të të ardhurave për mbulimin e shpenzimeve të kryera dhe (ndoshta) të pajustificuara. Në konkluzion, lidhur me diferencën e gjendjes cash, midis deklarimeve vjetore dhe deklaratës “*Vetting*”, në shumën prej 122.000 lekësh (qoftë në rastin se kjo do të trajtohet si një pasaktësi në deklarimin cash, por edhe në rast se do të konsiderohej si një mangësi financiare, për krijimin e kursimit cash të deklaruar), së bashku me pasaktësitë e trajtuara më sipër, për peshën minimale që ato mbartin në raport me tërësinë e procesit të rivlerësimit të subjektit dhe, në zbatim të parimit të proporcionalitetit, trupi gjyqësor i çmon si fakt/rrethanë të pamjaftueshme për të pasjellë, në rastin konkret, aplikimin pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, me pasojat e parashikuara prej tij (f. 18 e vendimit). Në këto kushte, shumica e trupit gjyqësor të Komisionit ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit, z. Astrit Kalaja,*

ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “a”, të ligjit nr. 84/2016.

3.2 Për kontrollin e figurës. Referuar nenit DH të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në konsideratë të verifikimit dhe të konfirmimit nga institucionet përgjegjëse për përshtatshmërinë e subjektit, edhe pas hetimit administrativ, ka arritur në përfundimin se: [...] *Në raportin e dërguar nga DSIK-ja vlerësimi i kryer nuk përmban rrethana bindëse, të mjaftueshme për të konkluduar për ndonjë favorizim apo ndikim të paligjshëm, nëpërmjet funksionit të tij, apo për konstatimin e ekzistencës së kontakteve të papërshtatshme me ndonjë person të përfshirë në krimin e organizuar. Gjithashtu, informacionet dhe dyshimet e ngritura mbi veprime korruptive (të përsëritura), nuk rezultojnë të provuara/bazuara, për të konkluduar bindshëm mbi përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në to [...] (f. 19 - 20 e vendimit). Në këto kushte, Komisioni, në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, nuk i konsideron të mjaftueshme informacionet, indiciet dhe dyshimet e ngritura për të konkluduar për papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vijueshmërinë e funksionit të tij. Për rrjedhojë, konstatimet e mësipërme nuk mund të konsiderohen si shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, sipas pikës 2, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.*

3.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale. Referuar nenit E të aneksit të Kushtetutës, nenit 43/2 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016, si dhe kreut II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, të ndryshuar, Komisioni, pasi ka administruar raportin e përgatitur nga KLGJ-ja, hetimin dhe vlerësimin e denoncimeve nga publiku dhe rekomandimin nga ana e relatorit të çështjes, ka konkluduar se nga vlerësimi i përgjithshëm i kriterit të aftësive profesionale, çmon se të dhënat e nxjerra nga disa prej dosjeve të administruara, si dhe konstatimet e bëra lidhur me mënyrën e të punuarit (*modus operandi*) të subjektit, problematikat që kanë rezultuar, nuk mund të klasifikohen si shkelje apo mangësi të rënda profesionale. Në këto rrethana, Komisioni ka çmuar se përfundimet e sipërcituara nuk përbëjnë shkaqe të mjaftueshme për të konkluduar për papërshtatshmërinë profesionale të subjektit të rivlerësimit dhe, si rrjedhim, ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Astrit Kalaja, ka arritur së paku nivelin minimal kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit ligjor, që e përcakton atë si prag kualifikimi. Ndërkohë, Komisioni ka përcjellë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, për inspektimin e shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore, bazuar në pikën 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, procedimin penal me nr.*** akti dhe nr. *** çështje, gjykuar nga Gjykata e Apelit Shkodër.

4. Vendimi i Komisionit. Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, shumica e trupit gjykues të Komisionit, pasi anëtarja e trupit gjykues znj. Brunilda Bekteshi ka dalë në pakicë dhe ndan mendim të kundërt për vlerësimin e kriterit të pasurisë, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale e, për këto arsye, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “a”, dhe nenin 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur: *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Astrit Kalaja.*

II. Vlerësimi i Komisionerit Publik

5. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting).

6. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisionerit Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër

vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim referuar si Kolegji).

7. Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore, që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

8. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.

9. Komisioneri Publik, nga shqyrtimi i vendimit nr. 224/2019, çmon se ai është i cenueshëm në tërësinë e tij dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t'u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit. Lidhur me rrethanat ligjore dhe të faktit, sikurse do të trajtojmë edhe në vijim, i jemi referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i cili, bazuar në nenin F të aneksit të Kushtetutës, është organi i vetëm gjyqësor që vendos për vlerësimin përfundimtar të këtyre çështjeve.

10. Ankimi i Komisionerit Publik, në rastin konkret, evidenton dhe parashtron rrethana dhe fakte ligjore, lidhur me: (i) pasaktësi dhe pamjaftueshmëri në deklarin e subjektit për dy pasuri të paluajtshme, të llojit apartament banimi dhe tokë arë, si dhe deklarime të pasakta/pamjaftueshme lidhur me posedimin e likuiditeteve *cash* ndër vite nga ana e subjektit, që kanë shërbyer si burim për blerjen e këtyre pasurive; (ii) mosdeklarim nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike të marrëdhënies financiare (hua) me z.***.***, si dhe mosdeklarimin e shlyerjes së kësaj huaje; (iii) mundësinë financiare e huadhënësit, z.***.***, për të mbuluar me burime të ligjshme huan e dhënë subjektit në shumën 3.300.000 lekë; (iv) pamjaftueshmëri financiare e subjektit të rivlerësimit për blerjen e dy pasurive të paluajtshme, të llojit apartament banimi dhe tokë arë.

11. Në referencë të përmbajtjes të nenit 4, pika 2, të nenit 59, pika 1, dhe nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik çmon se gjykimi i rrethanave ligjore dhe i fakteve të mësipërme nga ana e Kolegjit është i nevojshëm, me qëllim për të arritur në një vendimarrje të Kolegjit, në një vlerësim të përgjithshëm të të tria kritereve të rivlerësimit.

12. Në përfundim të sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 2 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenet 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik ankimon vendimin nr. 224, datë 20.12.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

III.A. Analiza e shkaqeve të ankimit

III.A.1 Kontrolli i pasurisë

13. Për sa i takon rivlerësimit të kriterit të pasurisë, referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30-33 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik mban në konsideratë se, gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit (“Vetting” dhe ato periodike), ku në çdo rast subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij dhe të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, si dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues.

14. Rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Astrit Kalaja, është subjekt deklarues për herë të parë në vitin 2003 dhe, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, dhe ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, ka dorëzuar në ILDKPKI, deklaratat e interesave private periodike për vitet 2003-2016 (në vijim DV- 20...) dhe në datë 27.1.2017 ka dorëzuar në ILDKPKI deklaratën “Vetting”, sipas shtojcës nr. 2 të ligjit nr. 84/2016.

15. Nga shqyrtimi dhe krahasimi i deklaratave periodike vjetore me deklaratën “Vetting”, referuar nenit 32, pika 5 të ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit D të aneksit të Kushtetutës, për kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimit dhe burimit të ligjshëm të pasurive, rezulton si vijon:

16. Pasuria nr. 1, “Apartament me sip. 109,5 m²”, ndodhur në lagjen “*.***”, Shkodër (në vijim referuar si “Apartament me sip.109,5 m²”)**

16.1 Në deklaratën “Vetting”, subjekti ka deklaruar: Pasuri e paluajtshme apartament banimi me nr. pasurie ***, z. k.*** me sip. të shfrytëzueshme 109,5 m², ndodhur në lagjen “***.***”, Shkodër. Vlera: 4.675.650 lekë. Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimit deklaruar si më poshtë:

16.1.1 Kësti i parë është paguar në muajin mars 2007, në vlerën 3.000.000 lekë. Burimi i krijimit: kredi e marrë nga Banka ***.*** (në vijim referuar si ***), Kontrata e kredisë nr. *** rep., nr.*** kol., datë ***.2.2007;

16.1.2 Kësti i dytë është paguar në cash në vitin 2009, në vlerën 1.675.650 lekë, para lidhjes së kontratës². Burimi i krijimit: të ardhurat nga shitja e “Apartamentit me sip. 63 m²”, me vendndodhje Shkodër³.

16.2 Në DV-2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Apartament me sip.120 m², ndodhur në lagjen “***.***”, Shkodër. Burimi i krijimit: blerë me kredi të marrë në *** – Shkodër, me vlerë 3.000.000 lekë, më datë ***.2.2007, paguar kësti i parë dhe mbetet për t’u paguar diferenca e çmimit. Vlera: 38.400 euro. Pjesa takuese: 100%.

16.2.1 Në rubrikën “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: (i) kredi e marrë nga ***, Shkodër, për blerje banese në vlerën 3.000.000 lekë, më datë ***.2.2007; (ii) detyrim firmës “****” sh.p.k., për blerje apartamenti: 13.400 euro.

16.3 Në DV-2009, subjekti i rivlerësimit, në rubrikën “Ndryshimet e interesave private pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, ka deklaruar: Pagesën e kështit të dytë, në vlerën 13.400 euro, me burim të ardhurat nga shitja e apartamentit me sip. 63 m².

16.4 Nga aktet e administruara në dosje rezulton se origjina e kësaj pasurie rrjedh nga Kontrata e sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.2.2008, lidhur midis shoqërisë “****” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit dhe të subjektit të rivlerësimit, z. Astrit Kalaja, në cilësinë e porositorit, dhe Kontratë shitblerje pasurie të paluajtshme me nr.*** rep., nr.*** kol, datë ***.7.2009, lidhur midis shoqërisë “****” sh.p.k., në cilësinë e shitësit dhe subjektit të rivlerësimit, z. Astrit Kalaja, dhe bashkëshortes së tij, znj.***.***, në cilësinë e blerësit. Vlera e pasurisë është 4.675.650 lekë.

² Kontratë shitblerje pasurie të paluajtshme me nr.*** rep., nr.*** kol., datë ***.7.2009.

³ Pasuria nr.***, z. k nr. ***, Shkodër. Shitur me kontratën nr.*** rep., nr.*** kol., datë ***.12.2007. Pagesa nga blerësi ***.***, derdhur cash në llogari të subjektit të rivlerësimit, në *** Bank, në datën ***.3.2008.

16.5 Bazuar në kontratat e sipërcituara,⁴ si dhe në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në DV-2007, DV-2009 dhe Deklaratën “*Vetting*”, rezulton se ky apartament është shlyer me dy këste. Kësti i parë, me vlerë 3.000.000 lekë, është shlyer në muajin mars 2007 dhe kësti i dytë, me vlerë 1.675.650 lekë, është paguar në vitin 2009, para lidhjes së kontratës së shitjes, të datës ***.7.2009.

16.5.1 Pagesat e kësteve të mësipërme janë deklaruar të paguara në cash, jashtë zyrës noteriale, dhe kohë më parë nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes së datës ***.2.2008 (rreth 12 muaj) dhe kontratës së shitjes së datës ***.7.2009 (rreth 2 muaj).

16.6 Në vijim analizojmë burimet e krijimit të pasurisë “*Apartament me sip.109,5 m²*”, respektivisht burimin e deklaruar: (i) kredi në vlerën 3.000.000 lekë, marrë nga Banka ***.***, dhe burimin e deklaruar (ii) të ardhura nga shitja e “*Apartamentit me sip. 63 m²*”.

16.7 *Lidhur me burimin, “Kredi në vlerën 3.000.000 lekë, e marrë nga Banka ***.***” (kësti i parë)*, referuar akteve në dosjen e Komisionit, rezulton se:

16.7.1 Subjekti i rivlerësimit, z. Kalaja, me kontratën e kredisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.2.2007, ka përfituar kredi në vlerën 3.000.000 lekë, nga Banka ***.***, me qëllim blerje apartamenti.

16.7.2 Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë bankare të subjektit të rivlerësimit pranë ***-së, rezulton se më datë ***.2.2007 është disbursuar shuma prej 2.970.000 lekësh dhe, në datën ***.2.2007, është tërhequr nga subjekti i rivlerësimit shuma 2.946.000 lekë.

16.7.3 Fillimisht, kjo kredi është garantuar përmes kontratës së hipotekimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë ***.2.2007, me objekt hipotekimin e “*Apartamentit me sipërfaqe 63 m²*”, në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes së tij, me palë ***-në, në cilësinë e kreditorit/përfitues, dhe palë hipotekuese, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij.

16.7.4 Në datën ***.12.2007 është bërë ndryshimi i sigurimit të kredisë dhe është hartuar kontrata e kredisë, ndërmjet të njëjtave palë, por duke u vënë kësaj radhe në garanci një depozitë bankare me vlerë 3.300.000 lekë, në emër të subjektit të rivlerësimit, me barrëdhënës subjektin e rivlerësimit, dorëzanëse bashkëshortja dhe palë kredidhënëse ***.

16.7.5 Shuma e mësipërme, me vlerë 3.300.000 lekë, rezulton e depozituar në *cash* nga z.***.***, në datën ***.12.2007, në llogarinë rrjedhëse në emër të subjektit të rivlerësimit, pranë ***-së, me përshkrimin: “*për garanci shlyerje kredie*”. Në datën ***.12.2007, subjekti e ka transferuar këtë shumë në llogarinë e garancisë në ***, po në emër të tij, me përshkrimin “*garanci për kolateral për kredinë e akorduar Astrit Kalaja*”.

16.7.6 Referuar DV-2007 – 2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar marrëdhënien e krijuar me shtetasin ***.***, e cila, duke qenë se përmban veprime kreditimi në emër të subjektit të rivlerësimit, rezulton e natyrës së marrëdhënies së interesit. Kjo marrëdhënie interesi, e krijuar në vitin 2007, është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit për herë të parë në deklaratën “*Vetting*”, të dorëzuar në ILDKPKI më datë 27.1.2017. Në këtë deklaratë, (*Vetting*), në rubrikën “*Të dhëna konfidenciale*”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: (i) ***.***.*** (***) *lidhje miqësore, ka garantuar kredinë e marrë në vitin 2007, marrëdhënie e mbyllur me mbylljen e kredisë.* (ii) *Person juridik “***” sh.p.k., marrëdhënie pune ndërmjet ***.***.*** (***) dhe personit juridik, ka ndikuar në garantimin e kredisë, duke mbështetur ***.***.*** (***) në veprimtarinë e tij ekonomike.*

16.7.7 Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës lidhur me: (i) marrjen e huas, mbartjen e detyrimit, shlyerjen e shumës, për

⁴ Kontratë sipërmarrje nr. *** rep., nr.*** kol., datë ***.2.2008, dhe Kontratë shitblerje pasurie të paluajtshme me nr. *** rep., nr.*** kol, datë ***.7.2009.

periudhën 2008 – 2013, ndaj z.***.***, si dhe (ii) ligjshmërinë e burimeve financiare të këtij të fundit, për shumën 3.300.000 lekë.

16.7.8 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e datës 10.12.2019, lidhur me (i) mosdeklarimin e huas, mbartjen e detyrimit të shumës 3.300.000 lekë ndaj huadhënësit dhe pagesat e subjektit për shlyerjen e këtyre shumave të pretenduara të kryera në vitet 2008-2013, ndër të tjera, ka deklaruar se: [...] *shuma 3.300.000 lekë nuk është hua...në asnjë rast nga ana ime kjo shumë nuk është konsideruar hua, pasi asnjëherë kjo shumë nuk është përdorur nga ana ime...kjo shumë nuk ka qenë asnjëherë në posedimin tim...për sa i përket pagesave të shlyerjes së shumës 1.300.000 lekë, këto shuma nuk janë vlerësuar nga ana ime si kthim pas i lekëve, ato janë konsideruar si konsum jetese, pa i vlerësuar si kthim shume*⁵ [...].

16.7.9 Lidhur me (ii) ligjshmërinë e burimeve financiare të z.***.***, për dhënien e shumës prej 3.300.000 lekë, në përgjigjet e datës 26.4.2019, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: [...] *sqaroj se ajo rrjedh nga pasuria e tij e fituar nga ligji 7698, datë 15.4.1991, "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", si dhe nga veprimtaria private në profesionin e bletërritësit dhe pronarit të Bar Restaurant "****"... z.***.***, që nga viti 1993, në cilësinë e pronarit të truallit, ka fituar pronësi mbi një lokal ushqimi social, të cilin e ka administruar deri në vitin 1996 dhe më pas e ka kaluar në pronësi të z.***.***, me kontratën e shitjes nr. *** rep., nr.*** kol., datë ***.2.1996, në shumën 28.500.000 lekë. Lokali është bërë pjesë e kapitalit të shoqërisë "****" sh.p.k. dhe është menaxhuar nga z.***.***.*

16.7.10 Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, bashkëlidhur përgjigjeve të datës 26.4.2019 ka paraqitur: (i) Vendim nr.1, datë 11.11.1993, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave; (ii) Akt shitblerje pronë pasuri të paluajtshme nr. *** rep., nr.*** kol., datë ***.2.1996; (iii) Vërtetim pronësie datë ***.5.1996, shoqëruar me hartën treguese; (iv) Deklaratë noteriale të z.***.***, të datave ***.12.2007, ***.10.2014 dhe ***.1.2017; (v) Vërtetime lëshuar nga z.***.***, administrator i shoqërisë "****" sh.p.k., të datës ***.10.2014 dhe ***.10.2016; dhe (vi) Lëvizje të llogarive bankare të z.***.*** dhe të bashkëshortes së tij, znj.***.***.

16.7.11 Komisioni, lidhur me mosdeklarimin e marrëdhënies me z.***.***, pas analizës së bërë, ka konkluduar se: [...] *...ndonëse rrethanat e sipërcituara çojnë në moscilësimin e marrëdhënies financiare, që është duke u analizuar si një hua, në kuptimin e nenit 1050 të Kodit Civil, fakt ky që e lehtëson disi pozitën e subjektit të rivlerësimit lidhur me mosdeklarimin e saj si një veprim/burim. Por nga momenti që marrëdhënia në fjalë ka sjellë përfitime/lehtësime të subjektit dhe ka gjeneruar, gjithsesi, një detyrim të subjektit ndaj z.***.*** për të kthyer te ky i fundit shumën prej 3.300.000 lekësh, pasi të përfundonte nevoja e garancisë financiare, subjekti duhej që të kishte deklaruar ekzistencën e këtij detyrimi financiar në faqet 5 dhe 6 të deklaratës periodike vjetore të vitit 2007, si dhe shuarjen e tij në periudhën përkatëse. Trupi gjykues çmon se, nisur nga rrethanat specifike, nga fakti që veprimi financiar është pasqyruar qartësisht në përshkrimin e veprimit bankar, mosdeklarimi i detyrimit në fjalë, në këtë rast, përbën një pasaktësi që nuk mund të çojë në aplikimin e pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016. (f. 10 e vendimit).*

16.7.12 Komisioni, lidhur me burimet financiare të z.***.***, shprehet se: [...] *i ka vlerësuar si të mjaftueshme për të justifikuar shumën prej 3.300.000 lekësh, të derdhura prej tij në bankën kredidhënëse, për garancinë financiare të kësaj të fundit, pasi pozicioni i tij financiar është provuar jo vetëm me gjendjet në llogaritë e tij bankare, por kryesisht me të ardhurat e konsiderueshme të realizuara nga shija e një prone në vitet e mëparshme, me çmim 28.500.000 lekë. Duke konsideruar faktin se z.***.*** nuk ka qenë subjekt deklarues në ILDKPKI dhe, për rrjedhojë, nuk është e verifikueshme vijueshmëria e gjendjes/zotërimit (qoftë edhe të pjesshëm)*

⁵ Referohuni shpjegimeve të rezultateve të hetimit datë 10.12.2019, faqe 8-9.

dhe destinacioni përfundimtar i kësaj shume, nuk mund të përjashtohet mundësia se shuma 3.300.000 lekë (e përdorur për rastin në fjalë) të burojnë pikërisht nga të ardhurat që z.***.*** ka përfitur nga shitja e sipërcituar (në një vlerë që kanë qenë më shumë se nëntëfishti i saj), pasi ato mund të jenë ruajtur në kohë, në gjendje cash në banesë apo të jenë depozituar në llogaritë bankare në momente të ndryshme. Për sa më sipër dhe në mungesë të provës së kundërt, trupi gjykues e vlerëson të justifikuar burimin e shumës prej 3.300.000 lekë (f. 9 e vendimit).

16.7.13 Komisioneri Publik çmon se këto konkluzione të Komisionit nuk janë të sakta, pasi nuk bazohen në një vlerësim të drejtë të të gjitha fakteve dhe rrethanave të dala nga aktet e administruara në dosje. Në vijim të arsytimit parashtrijmë qëndrimin për të cilat Komisioneri Publik ndan vlerësim të ndryshëm nga Komisioni.

16.7.14 Lidhur me mosdeklarimin e marrëdhënies së huas me z.***.***, rezulton se shuma prej 3.300.000 lekësh është derdhur cash nga z.***.*** në llogarinë e subjektit të rivlerësimit, i cili më pas e ka transferuar këtë shumë në një tjetër llogari garancie, po në emër të tij. Pra, subjekti i rivlerësimit, që prej datës ***.12.2007, ka fituar pronësinë e kësaj shume, duke e disponuar atë lirisht, me të cilën ai vetë (subjekti i rivlerësimit) ka garantuar bankën kredituese si hipotekues i kësaj garancie. Referuar akteve⁶ lidhur me kredinë në ***, të administruara në dosjen e Komisionit, z.***.*** nuk rezulton në asnjë prej tyre, me asnjë cilësi si dorëzanës, barrëdhënës, garantor apo ndonjë cilësi tjetër.

16.7.14.1 Më datë ***.12.2007, në të njëjtën datë të depozitimit të shumës në llogari të subjektit të rivlerësimit, z.***.*** ka bërë Deklaratën noteriale nr.*** rep., nr.*** kol., datë ***.12.2007, sipas së cilës deklaroi se ka arkëtuar në llogarinë e hapur pranë ***-së, dega Shkodër, në emër të z. Astrit Kalaja, shumën 3.300.000 lekë. Në këtë këtë deklaratë të hartuar, edhe në prezencë të subjektit të rivlerësimit, dhe nënshkruar prej tij, ndër të tjera, thuhet se: “hartohet edhe në prezencën e debitorit Astrit Kalaja, i cili është dakord dhe lëshohet me kërkesën e tij”. Nënvizojmë se në cilësinë e deklaruesit të vullnetit në këtë akt noterial është vetëm z.***.***.

16.7.14.2 Në datën ***.9.2008, nga llogaria e garancisë, subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar transferimin në llogarinë e tij rrjedhëse të shumës 35.000 lekë, e cila është përdorur për shlyerjen e kështit të kredisë për këtë muaj dhe është rikthyer në llogarinë e garancisë në datën ***.12.2009, pra, llogaria e garancisë është prekur duke kryer veprime në kredi dhe debi.

16.7.14.3 Me autorizim të subjektit të rivlerësimit, z.***.***, në datën ***.6.2010, ka tërhequr në cash nga llogaria e garancisë shumën prej 2.000.000 lekë.

16.7.14.4 Në datën ***.6.2011 është shlyer përfundimisht kredia e subjektit ndaj ***-së, ndërkohë pjesa e mbetur prej 1.300.000 lekësh në llogarinë e garancisë, ka mbetur e paprekur në këtë llogari në emër të subjektit të rivlerësimit deri më datë ***.2.2012 (datë në të cilën është tërhequr nga vetë subjekti).

16.7.14.5 Shuma e mësipërme ka qenë në dispozicion të subjektit të rivlerësimit dhe është përdorur prej tij përtej qëllimit të deklaruar si garanci për kredinë në ***, fakt ky i konfirmuar edhe nga përgjigjet e vetë subjektit,⁷ kur deklaroi se detyrimi prej 1.300.000 lekësh është shlyer gjatë periudhës 2008 – 2013, nga të ardhurat nga kursimet e tij.

⁶ Kontratë kredie, datë ***.2.2007; Kontratë hipotekimi, datë ***.2.2007; dhe Kontratë kredie bankare (siguruar me depozitë bankare), datë ***.12.2007.

⁷ Referohuni përgjigjeve të pyetjes 6, në pyetësorin nr. 2, dhe shpjegimeve të rezultateve të hetimit datë 10.12.2019, faqe 9.

16.7.14.6 Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DV-2008 – 2013 shlyerjet e detyrimit apo vlerën e mbetur dhe nuk ka paraqitur dokumentacion provues për shlyerjen e saj. Gjithashtu rezultoi se në DV-2012 subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar posedimin apo përdorimin e shumës së tërhequr nga llogaria e garancisë.

16.7.15 Sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se marrëdhënia e mësipërme përmbush të gjitha kushtet e nenit 1050 të Kodit Civil për t'u konsideruar më së paku një marrëdhënie huaje, pasi shuma 3.300.000 lekë, duke gjykuar nga natyra e veprimeve bankare dhe juridike, ka kaluar në pronësi të subjektit të rivlerësimit, është përdorur prej tij, si dhe pretendohet se i është kthyer z.***.*** deri në vitin 2013⁸, edhe pse marrëdhënia e kredisë që garantonte kjo shumë është mbyllur në datën ***.6.2011 dhe shuma e mbetur është tërhequr e gjitha në *cash* në datën ***.2.2012.

16.7.16 Komisioneri Publik çmon se në zbatim të ligjit nr. 9049/2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të deklarojë detyrimet financiare ndaj personave fizikë dhe juridikë, si dhe çdo ndryshim të këtyre detyrimeve, konkretisht subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të deklarojë mbartjen e detyrimit të shumës 3.300.000 lekë, si dhe shlyerjet e saj. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për vitet 2007-2013 lidhur me këtë pasuri.

16.7.17 Konkluzioni i mësipërm i Komisionerit Publik lidhur me mosdeklarimin e marrëdhënies së huas në deklaratat periodike vjetore, për periudhën 2008 – 2013, mbështetet edhe në qëndrimin e mbajtur në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për interpretimin dhe zbatimin e neneve 30 dhe 32, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, ku Kolegji ka trajtuar në disa vendime detyrimin për deklarim dhe vlerën provuese të deklaratave periodike vjetore, konkretisht në vendimet (JR) nr. 9/2018, (JR) nr. 5/2019 dhe (JR) nr.19/2019, pra ka vendimmarrje dhe është krijuar jurisprudencë, si:

16.7.17.1 Në vendimin nr. 9/2018, në pikën 42 të tij përcaktohet se [...] ... *Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit arsyeton se, duke u nisur nga sa parashikon Kushtetuta dhe ligji për plotësimin e deklaratës “Vetting” dhe shprehjes së ILDKPKI-së për konstatimet në këto deklarime, nuk e përjashton Komisionin apo Kolegjin nga kontrolli i këtyre deklarimeve, të cilat jo pa qëllim i dërgohen që nga viti 2003. Dispozitat ligjore që rregullojnë vlerën e deklarimeve të bëra në deklaratat periodike dhe deklaratën e pasurisë së rivlerësimit janë neni Ç, pika 4, dhe neni D i aneksit të Kushtetutës, si dhe nenet 30, 32 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016. Sipas përcaktimeve të neneve të sipërcituara, si Kushtetuta, edhe ligji kanë parashikuar shtrirjen e procesit të rivlerësimit edhe në shqyrtimin e deklarimeve periodike të pasurisë, të kryera në të shkuarën nga subjektet e rivlerësimit, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha sesa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur. Neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 parashikon: “Deklarimet e interesave private dhe pasurore, të paraqitura më parë tek ILDKPKI mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelit”. Ndërkohë, sipas nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me procesin e rivlerësimit të pasurisë, objekti i këtij vlerësimi është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të, elemente këto të cilat rezultojnë edhe nga deklaratimet periodike të pasurisë së subjekteve të rivlerësimit. Duke qenë se përcaktimet kushtetuese dhe*

⁸ Sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në shpjegimet në rezultatet e hetimit.

ligjore të sipërcituara u kanë dhënë deklarimeve periodike të pasurisë vlerën e provës, ato mund të konsiderohen të së njëjtës rëndësi me deklaratën e pasurisë “Vetting”. Komisioni apo Kolegji, këto deklarata, së bashku me provat e tjera, i vlerëson në tërësi me rrethanat e çështjes për të arritur në një konkluzion sa më të drejtë. Përveç kësaj, Komisioni ushtron kontroll edhe mbi aktin administrativ që është raporti i ILDKPKI-së për provueshmërinë dhe vërtetësinë e tij. [...]

16.7.17.2 Në vendimin nr. 5/2019, në pikën 23 dhe 24 të tij përcaktohet se [...] ... Në lidhje me procesin e vlerësimit të kriterit të pasurisë, sipas nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, objekt i këtij vlerësimi është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të. Ndërsa, sipas nenit 32, pika 5, deklaratimet e interesave private dhe pasurore, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja, mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji. Bazuar në këto përcaktime kushtetuese dhe ligjore, rezulton se deklarata e pasurisë për procesin e rivlerësimit nuk është dokumenti i vetëm, i mjaftueshëm për vendimmarrjen e Komisionit ose Kolegjit, por deklaratimet e interesave private dhe pasurore, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë prej tij. Deklarata e pasurisë së rivlerësimit ka të njëjtën përmbajtje me deklaratat periodike të pasurisë, me ndryshimin se në këtë deklaratë subjekti duhet të bëjë një pasqyrim të të gjitha pasurive të akumuluar në vite. Kontrolli dhe krahasimi i deklarimeve të mëparshme me deklaratën e pasurisë, gjatë vlerësimit të pasurisë, është i domosdoshëm, pasi u shërben organeve të rivlerësimit për të ndjekur ecurinë dhe vërtetësinë e deklarimeve të subjektit në lidhje me pasurinë e deklaruar dhe për të nxjerrë konkluzionet mbi mjaftueshmërinë e deklarimeve të tij apo ligjshmërinë e të ardhurave të tij në vite, si dhe të burimeve të krijimit të pasurisë. Sidomos, në rastin e vlerësimit të ligjshmërisë së burimeve të krijimit të një pasurie, vlerësimi i deklarimeve të mëparshme merr rëndësi të veçantë, pasi këtu paraqitet deklarimi i subjektit në momentin e krijimit të pasurisë, si dhe transaksionet e kryera në vite me këtë pasuri [...].

[...] ...Subjekti i rivlerësimit, deklaratën e pasurisë së rivlerësimit do të duhet ta plotësojë me një kujdes të posaçëm dhe me vërtetësi. Ligji nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë”, që nga momenti i hyrjes në fuqi të tij, ka pasur të qartë përgjegjësinë ligjore për subjektet e deklarimit dhe personat e lidhur me ta, si dhe sanksionet përkatëse, në rast të mosplotësimit me vërtetësi të deklaratës së pasurisë. Ligji nr. 84/2016, duke e përcaktuar procesin si rivlerësim dhe duke vendosur në bazë të procesit vetëdeklarimin e subjekteve, në frymën e tij, por edhe në përcaktimet e neneve 32, pika 5 dhe 33, pika 1, nuk ka si qëllim zhbërjen e legjislacionit në fuqi për deklarinin e kontrollin e pasurive, por përkundrazi synon realizimin e kontrollit të pasurisë së deklaruar në deklaratimet periodike dhe në deklaratën e rivlerësimit, si një kontroll të bazuar në deklaratimet në vazhdimësi të subjekteve të rivlerësimit [...].

16.7.17.3 Në vendimin nr. 19/2019, në pikën 22.14 dhe 22.15 të tij përcaktohet se [...] ... Trupi gjykues vëren se objekt i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit, janë edhe deklaratat e pasurisë të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja që, mbështetur në ligjin nr. 84/2016, nëse subjekti ka bërë deklarinin të pasaktë, ka fshehur pasurinë apo ka bërë deklarinin të rremë, në vitet përkatëse, nuk është element i mjaftueshëm për t’u konsideruar si një shkak i vetëm dhe i veçuar, që prodhon situatën e deklarimit të pamjaftueshëm, në kuptim të neneve 33, pika 5 dhe 61, pika 3, e ligjit nr. 84/2016, për shkarkimin e

subjektit, por ai mbetet një element, i cili konsiderohet në vlerësimin e përgjithshëm të kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit. Neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, përcakton që deklaratimet e interesave private dhe pasurore, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji. Këto deklaratat, së bashku me provat e tjera, vlerësohen në tërësi me rrethanat e çështjes, për të arritur në një konkluzion sa më të drejtë. Kontrolli i deklaratës “Vetting” dhe krahasimi i saj me deklaratimet e mëparshme, vlerësohet si mjet që shërben gjatë procesit të rivlerësimit për kriterin pasuror, për të ndjekur ecurinë dhe vërtetësinë e deklaratimeve të subjektit, në lidhje me pasurinë e deklaruar dhe për të nxjerrë konkluzionet mbi ligjshmërinë e pasurisë së subjektit apo mjaftueshmërinë e deklaratimeve të tij. Kjo merr vlerë specifike, sidomos në rastin e vlerësimit të ligjshmërisë së burimeve të krijimit të një pasurie, pasi këtu paraqitet deklarimi i subjektit në momentin e krijimit të pasurisë, si dhe transaksionet e kryera në vite me këtë pasuri. Kjo analizë është në përputhje edhe me vendimin nr. 2/2017, të Gjykatës Kushtetuese, në të cilin nënvizohet se organet e reja kushtetuese të procesit të rivlerësimit nuk kanë zhbërë sistemin ekzistues të kontrollit dhe vlerësimit të funksionarëve publikë. Po në këtë vendim, Gjykata Kushtetuese mban qëndrimin se kompetencat e organeve ekzistuese, siç janë ILDKPKI-ja, DSIK-ja apo organet e vlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, nuk mund të shihen të shkëputura nga kompetencat e organeve të rivlerësimit, pasi procesi i rivlerësimit është një proces kompleks, i cili në bazë të tij ka parimin e bashkëpunimit, të ndërveprimit dhe të kontrollit mes të gjitha organeve të përfshira në të [...].

[...] ... Trupi gjykues i Kolegjit vëren se secili nga paragrafët e nenit D të aneksit të Kushtetutës normon një situatë të caktuar gjatë procesit të rivlerësimit të subjekteve. Konkretisht, pika 1 parashikon qëllimin e kontrollit të pasurisë dhe të deklarimit, identifikimin e subjekteve që kanë pasuri të pajustificuar ose të subjekteve që nuk kanë deklaruar saktë dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe ato të personave të lidhur; pika 2 parashikon detyrimin për plotësimin e saktë dhe të plotë të deklaratës “Vetting” dhe detyrimin e ILDKPKI-së për të përpiluar një raport për ligjshmërinë e pasurive, saktësinë dhe plotësinë e deklarimit sipas ligjit; pika 3 parashikon detyrimin e subjektit për të shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të deklaruara; pika 4 parashikon se nëse deklarohet pasuri më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme, subjekti prezumohet fajtor për shkelje disiplinore dhe duhet të paraqesë prova që të vërtetojnë të kundërtën; dhe pika 5 parashikon rastin e mosdorëzimit të deklaratës në kohë apo përpjekjes për të fshehur, apo paraqitur në mënyrë të pasaktë pasurinë, gjë e cila shkakton prezumimin e masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të paraqesë prova që vërtetojnë të kundërtën. [...].

16.7.18 Lidhur me mundësitë financiare të z.***.*** për të mbuluar me burime të ligjshme shumën e dhënë hua në vlerën 3.300.000 lekë, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur “Akt shitblerje pasurie të paluajtshme” nr.***, datë ***.2.1996, me anë të së cilës z.***.*** (shitësi) i shet z.***.*** (blerësit), një birrari me sip. 610 m², në vlerën 28.500.000 lekë, veprim juridik i ndodhur rreth 11 vjet përpara huadhënies nga z.***.***.

16.7.19 Në Deklaratën noteriale nr.***, datë ***.10.2014, z.***.*** deklaroi se: “të ardhurat e mia si rezultat i veprimtarisë në Bar Restorant “***”, i veprimtarisë së ushqimit të bletarisë për prodhimin e mjaltit, si dhe kujdestarinë e pronave kanë qenë të mjaftueshme për të garantuar kredinë e z. Kalaja., pa cenuar veprimtarinë time private. Aq më tepër që në rast nevojë emergjente për para cash kam pasur edhe gatishmërinë e firmës “***” sh.p.k., ku pjesë e kapitalit të saj ishte dhe restoranti im.Për sigurimin e kredisë, një pjesë të kësaj shume e kam marrë edhe nga kapitale cash të vetë firmës (*** sh.p.k.), kapital i cili menaxhohej nga

vetë unë, pasi kjo shumë ishte në funksion të lokalit...”, deklarime të cilat konfirmohen edhe nga dy vërtetime të lëshuar nga z.***.***, administrator i shoqërisë “****” sh.p.k., të datës ***.10.2014 dhe ***.10.2016.

16.7.20 Nga ana tjetër, subjekti i rivlerësimit, z. Kalaja, në përgjigje të pyetësorit nr. 4 të Komisionit deklaroi se: “...nuk ka asnjë lidhje me shoqërinë “****” sh.p.k., për garantimin e kredisë, ajo nuk ka përdorur asnjë shumë të saj në favor të subjektit... Në deklaratën noteriale të z.***.*** dhe në vërtetimin e shoqërisë, cilësimi përfshirje në kapitalin themeltar të shoqërisë “****” sh.p.k. i lokalit berrari, është gabim”, deklarim ky kontradiktor me deklaratimet e z.***.*** dhe z.***.***.

16.7.21 Gjithashtu, kontradiktore paraqiten të dhënat mbi gjendjen juridike të pasurisë Bar Restorant “****”, pasi në deklaratën noteriale të datës ***.10.2014, z.***.*** deklaroi se në vitin 2009 Bar Restorant “****” ka kaluar nga pronësia e z.***.***, president i “****” sh.p.k. dhe është regjistruar në emër të tij, të nënës dhe motrës së tij, ndërsa z.***.***, president i “****” sh.p.k., në vërtetimin e lëshuar më datë ***.10.2016, deklaroi se Bar Restorant “****”, pronë e pronarit z.***.*** ka qenë pjesë e kapitalit themeltar të shoqërisë “****” sh.p.k., për periudhën 1997-2004 dhe pas këtij viti i ka kaluar sërish z.***.*** Nuk rezultoi asnjë akt i administruar me vlerë provuese për ecurinë në kohë të regjistrimeve për këtë pasuri në regjistrat kadastralë.

16.7.22 Komisioneri Publik vëren se, referuar akteve të administruara në dosjen e Komisionit mbi të ardhurat e ligjshme të z.***.***, si dhe nga verifikimi i llogarive bankare të z.***.*** dhe të bashkëshortes së tij znj.***.***, nuk provohet mundësia financiare e tyre për të mbuluar me burime të ligjshme huan e dhënë, si dhe nuk evidentohen transaksione të cilat të lidhen me momentin dhe vlerën e shumës së dhënë hua.

16.7.23 Sa më sipër, në vlerësimin e Komisionerit Publik, deklaratimet e subjektit të rivlerësimit dhe shtetasve ***.*** dhe ***.***, lidhur me burimin e krijimit të shumës 3.300.000 lekë, janë kontradiktore, duke krijuar paqartësi si në drejtim të identifikimit të huadhënësit real, ashtu dhe të verifikimit të mundësisë financiare të këtij të fundit për të mbuluar me burime të ligjshme këtë shumë.

16.8 Lidhur me burimin e deklaruar të ardhura nga shitja e “Apartamentit me sip. 63 m²” (kësti i dytë), referuar akteve në dosjen e Komisionit, rezultoi se:

16.8.1 Në DV-2009, subjekti i rivlerësimit, në rubrikën “Ndryshimet e interesave private pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, ka deklaruar: “Pakësim vlere në lekë, kam shlyer diferencën e çmimit të shtëpisë së re (13.400 euro) nga lekët e shtëpisë që kam shitur, e deklaruar në deklaratat të mëparshme. Nga shuma 3.500.000 lekë (vlere e shtëpisë së vjetër)”.

16.8.2 Nga aktet në dosjen e Komisionit rezultoi se me kontratë shitblerje me kusht nr. *** rep., nr.*** kol., datë ***.12.2007, subjekti i rivlerësimit ka shitur “apartamentin me sip. 63 m²” tek z.***.*** Në kontratë është parashikuar çmimi i shitjes prej 3.500.000 lekë, i cili do të shlyhet në llogarinë e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit pranë *** Bank.

16.8.3 Nga verifikimi i llogarive bankare rezultoi se blerësi ***.***, në datën ***.3.2008, ka depozituar cash në llogarinë e subjektit të rivlerësimit pranë *** Bank shumat 2.700.000 lekë dhe 600.000 lekë, me përshkrimin *derdhje për blerje shtëpie* (total 3.300.000 lekë).⁹ Në këtë llogari evidentohen dy tërheqje cash nga subjekti i rivlerësimit, respektivisht shuma 1.000.000 lekë, në datën ***.4.2008, dhe shuma 2.500.000 lekë, në datën ***.5.2008.

⁹ Në pyetësorin e datës 26.04.2019 subjekti deklaroi se diferencën prej 200.000 lekë e ka marrë në Cash përpara datës ***.12.2007, ndërkohë në DV 2007 nuk rezultoi që të ketë deklaruar të ardhura nga shitja e këtij apartamenti.

16.8.4 *Në DV-2008, në rubrikën “Ndryshime të interesave private pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, subjekti ka deklaruar: “të ardhura nga shitja e apartamentit të vjetër me kontratë nr. *** rep., datë ***.12.2007, derdhur në llogarinë e pagës *** Bank, në datën ***.3.2008 (diferenca nga çmimi me lekë cash, të dhëna në formë paradhënie), shuma 3.500.000 lekë”.*

16.8.4.1 Në të njëjtën rubrikë, subjekti deklaroi kursime *cash* në shumën 400.000 lekë, si dhe gjendje në llogari, në *** Bank, në shumën 437.732 lekë, ndërkohë nuk deklaroi posedimin ose jo si likuiditete apo kursime *cash* të shumës prej 3.500.000 lekësh, e përfituar nga shitja e apartamentit dhe e tërhequr *cash* nga llogaria bankare, në periudhën prill-maj 2008.

16.8.5 Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës lidhur me pamjaftueshmërinë e burimeve financiare në shumën 1.253.738 lekë në vitin 2009, për pagesën e këstit të dytë të apartamentit, si dhe në shumën 294.494 lekë, për shlyerjen përpara kohe të kredisë.

16.8.6 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e datave 26.4.2019, 30.10.2019 dhe 10.12.2019, ka pretenduar¹⁰ se shumatat e tërhequra nga llogaria bankare në *** Bank, në muajt prill – maj 2008 (referohuni pikës 16.8.3 më sipër) janë administruar *cash* në banesë, dhe: [...] *...në deklaratat periodike nuk është deklaruar gjendja në datën 31.12. të çdo viti, por vetëm shtesat në fund të vitit, në çdo vit kalendarik. Në deklaratimet e gjendjes cash nuk janë përfshirë e pasqyruar gjendjet në cash të krijuara nga tërheqjet nga llogaria e pagës dhe të kredive, me qëllim përmbushjen e detyrimeve ndaj të tretëve, pasi i kam vlerësuar të deklaruara në momentin kur ato janë fituar... Po ashtu me të njëjtën logjik veprimi kam ecur edhe në deklaratimin e pakësimeve...mospërputhja e këtyre deklaratimeve qëndron në faktin se në DPV janë bërë vetëm deklaratimet e shtesave në cash për çdo vit, por jo gjendjen kumulative në fund të çdo viti deklarues, pra është një gabim që ka ardhur nga kuptimi i gabuar i kërkesave të DPV-së në çdo vit...[...].* Bashkëlidhur përgjigjeve të datës 26.4.2019 dhe 10.12.2019, subjekti ka paraqitur në mënyrë tabelare shtesat, pakësimet dhe gjendjen e kursimeve në *cash* në fund të çdo viti deklarimi.

16.8.7 Komisioni, lidhur me mosdeklarimin e kursimeve në *cash*, arsyeton se [...] *në rastin konkret, nisur nga fakti që burimi i ligjshëm i shumës në fjalë, si dhe depozitimi dhe tërheqja nga llogaria bankare e subjektit, kanë rezultuar të provuara dhe duke pasur parasysh edhe vlerën e tyre të konsiderueshme, moskonsiderimi i tyre nga Komisioni, si të disponueshme në analizën financiare, vetëm për faktin se subjekti nuk e ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore, si gjendje cash në fund të vitit (për shkak të një konceptimi të gabuar të detyrimit për deklarim), por i ka deklaruar me saktësi si të ardhura nga shitja e pasurisë, do të përbënte një penalizim jo në proporcion me gabimin/mospërmbushjen e detyrimit formal nga subjekti, duke tejkaluar frymën e ligjit nr. 84/2016, që synon ndëshkimin e mungesës së burimeve të ligjshme dhe të pamjaftueshmërisë thelbësore të deklaratimeve, me anë të të cilave mund të jetë tentuar, apo realizuar pasqyrimi i një gjendje pasurore të deklaruesve të ndryshme nga realiteti. Në këtë rast, subjekti nuk ka deklaruar gjendjen cash të një shume të provuar më herët, si për burimin e ligjshëm, ashtu edhe mbi zotërimin fizik të saj... Për rrjedhojë, trupi gjykues çmon se duhet të konsiderohet me burim financiar të ligjshëm e gjithë pagesa e këstit të dytë për blerjen e apartamentit në vitin 2009 dhe, për pasojë, të gjitha shumatat e paguara nga subjekti për këtë pasuri rezultojnë të mbuluara me burime financiare të ligjshme, për faktin se disponibiliteti i shumave të arsyetuara në pikat e mësipërme i mbulon mangësitë e konstatuara në analizën financiare paraprake [...] (f. 11-12 e vendimit).*

¹⁰ Referohuni përgjigjeve të Pyetësorit nr. 2, faqe 7-8; Pyetësorit nr. 4, faqe 2; dhe shpjegimeve të rezultateve të hetimit, datë 10.12.2019, faqe 10-18.

16.8.8 Komisioneri Publik çmon se ky konkluzion i Komisionit nuk qëndron, pasi nuk bazohet në një vlerësim korrekt të të gjitha fakteve dhe rrethanave të dala nga aktet e administruara në dosje, me arsyetimin si më poshtë vijon:

16.8.8.1 Nga aktet në dosje rezulton se subjekti i rivlerësimit në DV-2008 ka deklaruar të ardhurat e realizuara nga shitja e “apartamentit me sip. 63 m²”, në vlerën 3.500.000 lekë, të depozituara në llogarinë bankare të pagës pranë *** Bank, të tërhequra *cash* nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës prill – maj 2008, për të cilat subjekti nuk ka deklaruar destinacionin apo posedimin e tyre në *cash* në fund të vitit kalendarik, duke bërë të pamundur gjurmimin e tyre.

16.8.8.2 Gjithashtu, në përgjigjet e datës 26.4.2019 dhe të datës 10.12.2019, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar dhe kryerjen e një shpenzimi mjekësor në vitin 2008, në shumën 1.000.000 lekë, shpenzim ky që nga njëra anë nuk rezulton të jetë deklaruar në DV-2008, në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 9049/2003 dhe, nga ana tjetër, është tregues i shpenzimeve të kryera nga subjekti i rivlerësimit gjatë këtij viti, duke mos përjashtuar mundësinë e ekzistencës së shpenzimeve të tjera të padeklaruara.

16.8.8.3 Për më tepër, subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e datave 26.4.2019 dhe 10.12.2019, ka qenë kontradiktor dhe ka deklaruar vlera të ndryshme të kursimeve vjetore të poseduara në *cash* për periudhën 2003-2016, konkretisht, për vitin 2006, në përgjigjen e datës 26.4.2019 deklaroi gjendje të kursimeve në shumën 1.000.000 lekë, ndërsa në përgjigjet e datës 10.12.2019 në shumën 600.000 lekë. Për vitin 2007, në përgjigjen e datës 26.4.2019 deklaroi gjendje të kursimeve në shumën 1.391.703 lekë, ndërsa në përgjigjet e datës 10.12.2019 në shumën 991.703 lekë. Për vitin 2008, në përgjigjen e datës 26.4.2019 deklaroi gjendje të kursimeve në shumën 4.291.703 lekë, ndërsa në përgjigjet e datës 10.12.2019 në shumën 3.891.703 lekë.

16.8.9 Për sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9049/2003 kursimet e poseduara në *cash*, dhe si rrjedhojë burimi i deklaruar i shumës së paguar për këstin e dytë në vlerën 1.700.000 lekë¹¹, nuk justifikohet me të ardhura të ligjshme.

16.9 Lidhur me pamjaftueshmërinë për shlyerjen e pjeshme të kredisë pranë ***-së, më datë ***.3.2010

16.9.1 Në DV-2010, subjekti i rivlerësimit deklaroi: Pakësim në vlerë në lekë, kam shlyer një pjesë të kredisë nga kursimet në *cash* në shtëpi (të përbërë nga: (i) kursimet në *cash* dhe (ii) lekë nga shitja e shtëpisë, deklaruar në deklaratimet e mëparshme¹²), vlera e shlyer 2.000.000 lekë.

16.9.2 Nga verifikimi i llogarisë në ***, rezulton se subjekti në datën ***.3.2010 ka depozituar në *cash* shumën 2.000.000 lekë, e cila është përdorur për mbyllje të pjeshme të kredisë në ***. Referuar deklaratave periodike vjetore, rezulton se shuma e akumuluar e kursimeve në *cash*, në fund të vitit 2009, është në vlerën 990.000 lekë.

16.9.3 Lidhur me burimin tjetër të deklaruar, të ardhura nga shitja e “apartamentit me sip. 63 m²”, në mungesë të deklarimeve të sakta të subjektit, ashtu siç kemi analizuar gjerësisht edhe më sipër në pikën 16.8.8, rezulton se diferenca e shumës së depozituar në *cash*, në datën ***.3.2010, për shlyerje të parakohshme të kredisë në ***, nuk justifikohet me burime të ligjshme.

¹¹ Duke qenë se subjekti deklaroi se e gjithë shuma e paguar si këst i dytë ka si burim të deklaruar të ardhurat nga shitja e apartamentit të mëparshëm, në vlerësimin e Komisionerit Publik e gjithë kjo shumë nuk justifikohet me burime të ligjshme.

¹² Subjekti i referohet apartamentit me sip. 63 m².

16.10 Konkluzionet e mësipërme të Komisionerit Publik lidhur me pamjaftueshmërinë e konstatuar në pagesën e këstit të dytë dhe shlyerjen e parakohshme të kredisë (pikat 16.8.9 dhe 16.9.3, më sipër) mbështeten edhe në qëndrimin e mbajtur në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për interpretimin dhe zbatimin e nenit D të aneksit të Kushtetutës, në veçanti lidhur me kuptimin e *pasurisë së ligjshme*, e ndërlidhur me momentin e deklarimit në deklaratat periodike të *likuiditeteve*. Kolegji ka trajtuar në disa vendime edhe pretendimet e ngritura lidhur me deklarimin e likuiditeteve, konkretisht në vendimet (JR) nr. 7/2019, (JR) nr. 11/2019, (JR) nr. 19/2019, (JR) nr. 20/2019 dhe (JR) nr. 29/2019, pra ka vendimmarrje dhe është krijuar jurisprudencë, si:

16.10.1.1 Në vendimin nr. 7/2019, në pikën 39 të tij, përcaktohet se: [...] ... *bazuar në nenin 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji orienton Komisionin që për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme në të ardhmen të mos konsiderojë si të ardhura të subjekteve të rivlerësimit dhe personave të lidhur me ta, vlerat monetare të përfituara në formën e dietës për rimbursimin e shpenzimeve nga organizatorët e aktiviteteve të ndryshme profesionale, ku ata kanë qenë pjesëmarrës, si dhe të mos prezumojë përdorimin nga subjektet të gjendjeve cash si burime për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, për sa kohë një gjë e tillë nuk është deklaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë nga vetë subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike [...].*

16.10.1.2 Në vendimin nr. 11/2019, në pikën 27.12.18 të tij, përcaktohet se: [...] *Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues çmon se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për mënyrën e tij të deklarimeve të kursimeve në formën e likuiditetit cash jashtë sistemit bankar është jo vetëm në kundërshtim me ligjin, por edhe pretendim alogjik në kuptim të nocionit të kursimit. Në përfundim, trupi gjykues çmon se analiza ekonomiko-financiare në formë tabelare, e paraqitur nga subjekti, nuk ka vlerë provuese në drejtim të mënyrës së deklarimit të kursimeve të subjektit dhe të personave të lidhur me të, si dhe të mënyrës së përdorimit prej tyre të këtyre kursimeve. Për rrjedhojë, këto kursime në formën e likuiditetit cash jashtë sistemit bankar, shtesat dhe pakësimet e tyre do të merren parasysh nga trupi gjykues, sipas deklarimeve të subjektit dhe personave të lidhur me të, në deklaratat periodike/vjetore, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi [...].*

16.10.1.3 Në vendimin nr. 19/2019, në pikën 84 të tij, përcaktohet se: [...] *Lidhur me deklarimin gjatë gjykimit mbi mbajtjen e shumës prej 900.000 lekësh si cash në shtëpi, trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursime në cash në vlerat 300.000 lekë dhe 600.000 lekë, respektivisht në deklaratat periodike vjetore të vitit 2003 dhe në atë të vitit 2004. Në vijim, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë deklaruar ndryshime, shtime apo pakësime të gjendjes cash. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson të theksojë se si subjekt deklarimi pranë ILDKPKI-së prej vitit 2003, mbështetur në ligjin nr. 9049/2003, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij ndër vite, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të deklaronte çdo ndryshim të mundshëm të gjendjes së kursimeve cash, nëse kjo kishte ndodhur në vitin respektiv. Në formularin e deklaratës së pasurisë, në seksionin: “Ndryshimet e interesave private pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, kërkohet nga deklaruesit: Përshkruani hollësisht ndryshimet (shtesa dhe pakësime) në: [...] të çdo lloj pasurie, të paluajtshme dhe të luajtshme, likuiditete, të regjistruara ose jo në regjistrat publikë, për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit. Kjo rubrikë e deklaratës detajon detyrimin për zbatim të nenit 4, germa “d” e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, që parashikon: [...] Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë [...] brenda datës 31 mars të çdo viti gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: [...] d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në cash, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj [...].*

16.10.1.4 Në vendimin nr. 20/2019, në pikën 55 dhe 56 të tij, përcaktohet se: [...] *Ligji nr. 9049/2003 dhe formulari i deklarimit të pasurisë përcaktojnë detyrimin e subjektit deklarues të deklarojë në formën e përcaktuar prej tyre dhe jo të zgjedhin ata mënyra të personalizuar për të kryer këtë detyrim ligjor. Forma e deklarimit nuk është trajtuar prej ligjit si një detyrim alternativ, i cili mbetet në vullnetin e subjektit, por një detyrim i mirëpërcaktuar, i cili duhet respektuar. ... Në këndvështrim të kuadrit ligjor, subjekti ka detyrë të deklarojë duke prezantuar një fotografi të interesave të tij pasurore e të drejtave mbi pasuritë e paluajtshme e të luajtshme në fund të çdo viti kalendarik, kurse institucionet verifikuese dhe kontrolluese të këtyre deklarimeve do të duhet më pas të ndjekin konceptet e logjikës dhe matematikës, përfshi rregullat kontabël për të konkluduar nëse këto deklarime prodhojnë ndonjë situatë të shkeljes së ligjit prej subjektit deklarues [...].*

16.10.1.5 Në vendimin nr. 29/2019, në pikën 31 të tij, përcaktohet se: [...] *Referuar nenit 4, pika "d" e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, të ndryshuar, sipas të cilit subjektet detyrohen të deklarojnë "vlerën e likuiditeteve, gjendjen në cash jashtë sistemit bankar në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj", trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, përveç ndryshimeve të ndodhura në pasuritë, detyrimet financiare dhe interesat private, duhet të deklaronte saktë edhe gjendjen e kursimeve në formë likuiditetesh cash apo në bankë, në fund të çdo viti, prej vitit 2003 e në vazhdim. Bazuar në nenin D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar tatimet [...].*

16.11 Në përfundim, Komisioneri Publik, referuar dhe jurisprudencës së mësipërme të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, lidhur me pasurinë "apartament me sip.109,5 m²", vlerëson se, në kuptim të nenin D, pikat 1, 3 dhe 5 të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, germa "b" e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, pasi nuk ka deklaruar marrëdhënien financiare me z.***.***, nuk ka provuar mundësinë financiare të këtij të fundit për të mbuluar me burime të ligjshme huan e dhënë, si dhe nuk mbulon me burime të ligjshme shlyerjen e këstit të dytë dhe shlyerjen e parakohshme të kredisë në ***.

17. Pasuria nr. 2, "Tokë arë me sip. 379 m², ndodhur në *.***, Shkodër"**

17.1 Në deklaratën "Vetting", subjekti ka deklaruar: Pasuri e paluajtshme tokë arë me sipërfaqe 379 m², nga e cila 120 m² është rrugë kalimi dhe ka një ndërtim informal përdhes, me sipërfaqe të shfrytëzueshme rreth 60 m², me sipërfaqe solete 85 m². Regjistruar në regjistrin e ZVRPP-së Shkodër, vol. ***, faqe ***, e ndodhur në fshatin ***, ***, Velipojë. Kontrata e shitjes me nr.*** rep., nr.*** kol., lidhur me datë ***.7.2013. *Vlera:* 1.800.000 lekë. *Burimi i krijimit:* Kredi e marrë në *** Bank, më datë ***.5.2011. *Pjesa takuese:* 100%.

17.2 Në DV-2013, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Pasuri e paluajtshme tokë arë me sipërfaqe 379 m², nga e cila 120 m² është rrugë kalimi dhe ka një ndërtim informal përdhes rreth 60 m². *Vlera:* 1.800.000 lekë. *Burimi:* Kredi e marrë në *** Bank më datë ***.5.2011. *Pjesa takuese:* 100%.

17.3 Në DV-2011, subjekti i rivlerësimit, në rubrikën: "Ndryshimet e interesave private pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme", ka deklaruar: Cash në shtëpi në shumën 500.000 lekë nga kursimet e pagave të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes. *Gjendja e llogarisë në *** Bank është shtuar në shumën 2.000.000 lekë nga kredia e marrë pranë kësaj banke, në muajin maj 2010*¹³.

¹³ Kjo kredi, referuar akteve nga *** Bank në dosje të Komisionit, rezulton e marrë në vitin 2011.

17.4 Në DV-2012, subjekti i rivlerësimit, në rubrikën: “Ndryshimet e interesave private pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, ka deklaruar: Cash në shtëpi, në shumën 250.000 lekë, nga kursimet e pagave të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes. Gjendja e llogarisë në *** Bank është në shumën 102.359 lekë, si kursime nga paga e tij vjetore.

17.5 Referuar akteve në dosjen e Komisionit, origjina e pasurisë “Tokë arë me sip. 379 m²” rrjedh nga Kontrata e shitjes nr.*** rep., nr.*** kol., datë ***.7.2013, lidhur midis shtetasve ***.*** dhe ***.***, në cilësinë e shitësve, dhe subjektit të rivlerësimit z. Astrit Kalaja, në cilësinë e blerësit. Çmimi i shitjes së pasurisë është 1.800.000 lekë, shumë e shlyer nga pala blerëse jashtë zyrës noteriale. Në rubrikën e informacioneve në kontratë përshkruhet se në këtë sipërfaqe ka një ndërtim informal rreth 60 m², i cili shitet së bashku me pasurinë tokë arë.

17.6 Gjithashtu, rezulton se më datë ***.5.2011 subjekti i rivlerësimit ka përfituar një kredi konsumatore me hipotekë në *** Bank për shumën 2.200.000 lekë, e siguruar me pasurinë e tij: “Apartamentin me sip.109,5 m²”. Pas disbursimit të kredisë, gjendja në llogarinë në *** Bank, në datën 31.12.2011, është në shumën 1.991.122 lekë, e deklaruar kjo gjendje likuiditeti në DV-2011¹⁴. Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë së pagës së subjektit në *** Bank, rezulton se në datën ***.6.2011, subjekti i rivlerësimit ka tërhequr në cash shumën 900.000 lekë, shumë e cila në të njëjtën ditë është depozituar në *** për shlyerjen përfundimtare të kredisë pranë kësaj banke.

17.7 Në datën ***.2.2012, subjekti i rivlerësimit ka tërhequr në cash nga kjo llogari shumën 2.000.000 lekë. Gjendja më datë 31.12.2012, në llogarinë në *** Bank është 102.237 lekë, e deklaruar kjo gjendje likuiditeti në DV-2012, ndërkohë në këtë DV subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë deklaruar posedimin në cash të shumës së tërhequr më datë ***.2.2012.

17.8 Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës lidhur me mundësinë financiare të tij për të paguar të gjithë shumën për blerjen e pasurisë “Tokë arë me sip. 379 m²”, pasi ka rezultuar me një bilanc negativ në shumën prej 898.477 lekë.

17.9 Subjekti i rivlerësimit, z. Kalaja, në përgjigjet e datës 10.12.2019, deklaroi se: “... nuk jam në pamjaftueshmëri financiare dhe vlerësoj se është e nevojshme të bëj edhe një analizë tjetër duke iu referuar deklaramenteve të mia të gjendjes cash, pra në një këndvështrim tjetër. Konstatimi i raportit se kjo shumë nuk është pasqyruar në rritjen e kursimeve në cash, mendoj se ka ndodhur për shkak se, duke qenë se është deklaruar në llogarinë bankare, e kam konsideruar si një deklarament të ardhur që është bërë në gjendjen e llogarisë. Është ky shkak që unë pas tërheqjes së parave nga banka nuk i kam deklaruar si shtesë në cash, pasi e kam vlerësuar se është e vërtetuar dhe e deklaruar kjo shumë dhe burimi. Në vitin 2011, unë kam deklaruar vetëm shtesën në cash në masën 500.000 lekë, pa përfshirë shumën e tërhequr nga banka gjatë vitit 2011. Në deklaramentin për vitin 2012, unë kam deklaruar vetëm shtesën 250.000 lekë, por nuk kam deklaruar gjendjen në cash shumën 2.000.000 lekë, shumë e tërhequr nga llogaria ime e pagës në bankën ***, në datën ***.2.2012. Është bërë i njëjti gabim: është deklaruar vetëm shtesa në cash në atë vit dhe jo gjendja totale në cash” (faqe 12 e përgjigjes).

17.10 Komisioni ka vendosur se i konsideron të besueshme dhe bindëse shpjegimet e subjektit lidhur me burimet e krijimit të kësaj pasurie¹⁵, ku, ndër të tjera, si një ndër shkaqet arsyetohet se:

17.10.1 Komisioni vlerëson se një tjetër shkak, që e bën më bindës shpjegimin se subjekti e dispononte shumën prej 2.000.000 lekësh, por ka munguar në deklaramentin si gjendje cash në fund të vitit 2012, dhe e bën më të aplikueshëm konsiderimin e pasaktësisë në deklarament sesa mungesën e burimit financiar, është deduktimi i analizës logjike, sipas së cilës në rastin konkret

¹⁴ Shuma e deklaruar 2.000.000 lekë.

¹⁵ Pika 2.9, faqe 14 e vendimit.

do të gjendeshim përballë një paradoksi: nga njëra anë do të konsideronim jo të disponueshme një shumë prej 2.000.000 lekësh të provuar dhe të dokumentuar lidhur me burimin e saj të ligjshëm dhe me ekzistencën konkrete (në llogarinë bankare të subjektit), por nga ana tjetër, për të njëjtin vit 2012, do të konsideronim të disponueshme shumën prej 250.000 lekësh (të deklaruar si gjendje cash në fund të vitit 2012), vetëm për faktin e deklarimit dhe të mundësisë financiare (hipotetike) të rezultuar nga analiza financiare. Kjo nuk do të thotë që të vihet në dyshim ligjshmëria e shumës prej 250.000 lekësh, por duke aplikuar një arsyetim logjik, konsiderimi si të disponueshme edhe të shumës prej 2.000.000 lekësh, sipas Komisionit, do të përmbushte dhe do të kënaqte harmonizimin e frymës dhe të përmbajtjes së dispozitave ligjore me interpretimin dhe cilësimin e fakteve në mënyrën më korrekte dhe më objektive të mundshme, në rastin konkret (f.15 e vendimit).

17.11 Komisioneri Publik çmon se ky konkluzion i Komisionit nuk qëndron, pasi nuk bazohet në zbatimin e ligjit në situatën faktike dhe jurisprudencën e krijuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, sikurse argumentuar edhe më sipër në pikën 16.10, mbi deklarimin e vlerës së likuiditeteve.

17.12 Në përfundim, Komisioneri Publik, lidhur me pasurinë “Tokë arë me sip. 379 m²”, vlerëson se në kuptim të nenin D, pikat 1, 3 dhe 5 të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, pasi nuk mbulon me burime të ligjshme blerjen e kësaj pasurie në vitin 2013, në vlerën 1.800.000 lekë, për sa kohë që në DV-2012, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar posedimin në *cash* të shumës 2.000.000 lekë, të tërhequr nga *** Bank më datë ***.2.2012, pra ai gjendet në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve për krijimin e pasurisë.

III. Kërkimi i ankimit

18. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se ndryshe nga sa ka disponuar Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë;

19. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

20. Bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, DH, E dhe F të aneksit të Kushtetutës, nenit 4 dhe nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016;

21. Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe, në zbatim të nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 224, datë 20.12.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Astrit Kalaja.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA